

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Prag përplasje në qiell. Avionët e Suedisë dhe Finlandës i zënë pritë atyre të Rusisë
ADRESA	https://www.gazetatema.net/bota/prag-perplasje-ne-qiell-avionet-e-suedise-dhe-finlandes-i-zene-prite-atyre--i588355
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 14:17:23 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 14:15:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	80aba1c5dc0e1ab198cf3a7161d57df962f8907c4be3182bf60c57e2b171681b
TEKSTI	a3b42adcefc41754b42a77d391216828eb6cd6f31b2633d234f8492db748a424
PAMJA	44316bfe957d2fbd07e0223ac06853348e4390df57336182857ff859e66ff698

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	ac6a71ab69e51c22d03d43132b3a05d0fc4bbc1db72b6e33cdd0e5a136b4c747
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	3a6c0ee943067392b175e06ac07a7b9996bbd474953cea4f063ab0e5555023da
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/ac6a71ab69e51c22d03d43132b3a05d0fc4bbc1db72b6e33cdd0e5a136b4c747>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by
[Kontakt](#)

English

1 e [Prag përplasje në qiell. Avionet e Suedisë dhe Finlandës i zënë pritë atyre të Rusisë](#)sh-sulmuesi i Anglisë rretën traumën."Jam sulmuar seksualisht nga një personazh i fundit

Prag përplasje në qiell. Avionët e Suedisë dhe Finlandës i zënë pritë atyre të Rusisë



25 Shtator 2026, 16:15Bota TEMA



Rusia vazhdon t'u bjerë daulleve të luftës me NATO-n. Avionë luftarakë suedezë dhe finlandezë u ngritën në ajër për të kapur dhe identifikuar avionë ushtarakë rusë në hapësirën ajrore ndërkombëtare mbi Gjirin e Finlandës.

Misioni ishte pjesë e kuadrit më të gjerë finlandez-suedez për monitorimin dhe mbrojtjen e hapësirës ajrore të të dyja vendeve, njoftoi forca ajrore në një deklaratë. Avionët luftarakë të dy forcave ajrore gjurmuan dhe identifikuan një grup avionësh rusë, përfshirë një aeroplan transporti dhe disa avionë luftarakë, shtuan autoritetet.

Rajoni i Detit Baltik, pjesë e të cilit është Gjiri i Finlandës, është në gatishmëri të lartë pas incidenteve që përfshijnë ndërprerje të tubacioneve të gazit, shkelje të hapësirës ajrore dhe lëshimit të dronëve që nga pushtimi i plotë i Ukrainës nga Rusia në vitin 2022.

Tensionet vijnë në një kohë kur inteligjencat e perëndimit japin alarmin për një sulm të mundshëm nga ushtria e Vladimir Putinit ndaj një vendi të NATO-s apo Europës.

Thomas Ahrenkiel, shef i Inteligjencës në Danimarkë, tha: "Ne vlerësojmë se Rusia do ta përshkallëzojë më tej luftën e saj hibride kundër nesh në muajt në vijim, me një numër në rritje të sulmeve të tentuara që synojnë të shkaktojnë dëme më të mëdha se më parë. Është një situatë e rrezikshme, sepse sjellja e Rusisë kontribuon në zbehjen e vijës ndarëse midis luftës dhe paqes. Ne gjithashtu vlerësojmë se ekziston një rrezik i vogël, por në rritje, që Rusia të ndërmarrë hapin e kryerjes së sulmeve të kufizuara ushtarake kundër një ose më shumë vendeve të NATO-s që kufizohen me Rusinë".

Ndërkohë, ditë më parë në media u raportua për një alarm të CIA-s amerikane se Rusia mund të lëshojë dronë sulmues në drejtim të Italisë, Francës dhe Spanjës.

Autoritetet e këtyre shteteve nuk kanë konfirmuar vërtetësinë e këtij alarmi të inteligjencës së SHBA-ve, por presidenti Emmanuel Macron ka pohuar se ekziston rreziku i një përshkallëzimi me Rusinë.



Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Trump i hap dyert presidentit kinez, por ua mbyll mediave amerikane](#)

15:50 Bota

E dënuar për mashtrim të investitorëve, themeluesja e Theranos drejt lirimit nga burgu

14:30 Bota

Alarm në Poloni, sulmet kibernetike vënë në rrezik të dhënat shëndetësore

14:10 Bota

Zelensky i bën thirrje BE-së: Na duhen urgjentisht 27 miliardë dollarë

13:30 Bota /3 komente



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.